



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/235

Datë: 05.05.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, qeshor 2008", në bazë të nenit 9, nenit 10 dhe paragrafi 1 pika (a), të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –IV- (katërt) të rregullt të mbajtur me datë: 28.04.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR ORGANIZIMIN E DITËS SË ÇLIRIMIT DHE DITËS SË DËSHMORËVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS ME 16 QESHOR 2023

1.Miratohet formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, e cila do të organizohet me 16 Qeshor 2023.

2.Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Këshilli Organizativ do të jetë në këtë përbërje:

2.1.Ekrem Kastrati- Kryetari i Komunës-Kryesues i Këshillit Organizativ

2.2.Argjend Thaçi-Kryesues i Kuvendit të Komunës-anëtar

2.3.Fitim Shala-Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport-anëtar

2.4.Amrush Helshani-Nisma Socialdemokrate-anëtar

2.5.Alban Kastrati-PDK-anëtar

2.6. Arlind Morina -LDK-anëtar

2.7.Ilaz Krasniqi-VV-anëtar

2.8. Eqrem Morina –AAK-anëtar

2.9. Metush Kryeziu, përfaqësues i Shoqatave të daluara nga Lufta e UÇK-së-anëtar.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

